



INSTITUCIONET E PËRKOQSHME  
VETËQEVERISËSE  
Ministria e Arsimit e Shkencës  
dhe e Teknologjisë

PROVISIONAL INSTITUTIONS  
OF SELF-GOVERNMENT  
Ministry of Education, Science  
and Technology

PRIVREMENE SAMOUPRAVNE  
INSTITUCIJE  
Ministartstvo za Obrazovanje,  
Nauku i Tehnologiju

## UDHËZIM ADMINISTRATIV

LENDË: Kompensimi i orëve të pambajtura prej 1-14 tetor 2002

NUMËR: MASHT (1) 18/2002

DATË: 23 tetor 2002

Në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/19 te dt. 4 tetor 2001 të Degës së Ekzekutivit të Institucioneve Kalimtare të Veteverisjejs ne Kosovë, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë ( në tekstin e mëtejme MASHT) nxjerrë këtë Udhëzim Administrativ:

### Paragrafi 1

#### Synimi

Synimi i këtij Udhëzimi Administrativ është:

1.1. Krijimi i një orari për kompensimin e orëve të humbura te mësimin si pasojë e grevës së arsimtarëve në tetor 2002. Në të dy gjysmëvjetoret e vitit shkollor do të shtohen orë plotësuese në mënyrë që nxënësit të mos dëmtohen si pasojë e grevës.

1.2. Të krijojë një dispozitë për një ditë pune shtesë të cilën e patën humbur shkollat më 25 tetor 2002 me rastin e përgatitjes së qendrave të votimit për zgjedhjet komunale që u mbajtën ditën pasuese.

### Paragrafi 2

#### Korrigjimi i Udhëzimit të mëparshëm Administrativ

2.1. Për të arritur synimin e përmendur më lartë, paragrafi 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it (I) 11/2003 të Kalendarit për vitin shkollor 2002/2003 janë ndryshuar me paragrafin 3 dhe 4 të shënuar më poshtë.

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë  
Ndërtesa e EXIMKOS-it  
Rruga: Nëna Terezë, Prishtinë, Kosovë

Ministry of Education, Science & Technology  
EXIMKOS BUILDING  
Street: Mother Theresa, Pristina, Kosovo

Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije  
Zgrada EXIMKOS-a  
Ulica: Majka Tereza, Priština, Kosovo

Tel: (381)-(-38)-504-604 Ext. 4618/4518 E-mail: [unmik\\_edu@hotmail.com](mailto:unmik_edu@hotmail.com) Fax: 038-504-604-4668 via NY + 1 (212) 963 8603/8311

### Paragrafi 3

#### Orët e gjysmëvjetorit të parë

3.1. Gjatë gjysmëvjetorit të parë të gjitha shkollat do të mbajnë orë plotësuese në këto data:

- E shtunë 2 nëntor 2002
- E shtunë 9 nëntor 2002
- E shtunë 16 nëntor 2002
- E shtunë 23 nëntor 2002
- E shtunë 30 nëntor 2002 dhe
- E shtunë 7 dhjetor 2002

3.2. Në përputhje me paragrafin 1.2 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it (I) 11/2002 gjysmëvjetori i parë i vitit shkollor do të përfundojë më 20 dhjetor 2002

### Paragrafi 4

#### Orët e gjysmëvjetorit të dytë

4.1. Në gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor, respektivisht në fund të të gjysmëvjetorit të dytë, të gjitha shkollat në Kosovë do të mbajnë edhe pesë dite pune shtesë sipas orarit të poshtëshënuar:

4.2. Klasave prej I deri VIII-të do t`iu shtohet në fund të gjysmëvjetorit të java prej 16-20 qershor 2003. Rjedhimisht gjysmëvjetori i dytë do të përfundojë më 20 qershor 2003

4.3. Klases IX dhe viteve II dhe III të shkollave të mesme do t`iu shtohet në fund të gjysmëvjetorit java prej 2 – 6 qershor 2003.

4.4. Vitit IV të shkollave të mesme do t`iu shtohet në fund të gjysmëvjetorit dytë java prej 12- 16 maj 2003. Rjedhimisht gjysmëvjetori i dytë do të përfundojë më 16 maj 2003.

### Paragrafi 5

#### Hyrja në fuqi

5.1. Ky Udhëzim Administrativ do të hyjë në fuqi më 23 tetore 2003

---

Rexhep Osmani, Ministër